



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:155846

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05454097

C-IV.-22-0077

Ankuesi

Q I nga f.sh S K. Viti.

Kundër

E paditura

N.SH “Bentokos” – Viti, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht** ankesa dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI067-0058 dt.11 dhjetor 2013.
- II. **OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit Q I në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së marrëdhënies së punës t’i paguaj **shumën prej 1,356.00€** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore t’i paguaj shumën prej 135.60€. Shuma e kërkuar përtej lartësisë së aprovuar u refuzua si e pa bazuar.

Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.14 janar 2014, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI067-0058 i dt.13 dhjetor 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 2,268.00€, nga NSH “Bentokos” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka pohuar se ka qenë u punësuar për kohë të pacaktuar te e paditura dhe se asnjëherë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Kërkesën e kam paraqitur në momentin e likuidimit. Kërkesa është ligjore dhe gjen mbështetje në dispozitat ligjore. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Kopja e vendimit të atakuar, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Lista e punëtorëve që i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të ardhurave nga shitja e NSH-së.

Me dt.22 mars 2016, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje ku ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Kërkesa e ankuesit është e parashkruar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Parashtruesi nuk ndërmori asnjë veprim ligjor nga dt.29.06.2008 kur i lindi e drejta që të kërkoj kompensim deri me dt.29.06.2011. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit.

Me dt.11 dhjetor 2018, gjykata lëshoj për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Lidhur me këtë çështje me dt.24 prill 2019, DHPGJS nxjerr aktvendim me të cilin ankesën e ankuesit kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.GJI067-0058 të dt.13 dhjetor 2013, e ka konsideruar si të tërhequr, duke vendosur që secila palë të i bartë shpenzimet procedurale.

Me aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-19-0066 dt.07 prill 2022, lënda është kthyer në rigjykim te shkalla e parë.

Duke vepruar sipas aktvendimit dhe sugjerimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, kjo gjykatë është lëshuar në merita të ankesës dhe me dt.04 janar 2024 ka lëshuar një urdhër për ankuesin, me të cilin ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore siç është kopja e librezës së punës, kopja e listës së pagave si dhe prova të tjera shtesë.

Me dt.17 janar 2024, ankuesi iu është përgjigjur urdhrorit përmes një parashtrëse me të cilën ka bërë dorëzimin e këtyre provave: Kopjen e librezës së punës, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e Trustit Pensional, Lista e punëtorëve të NSH “Bentokos” – Viti si dhe kopjen e ankesës së dorëzuar në DHPGJS.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 71 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi parashtrori kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit/Agjencia Kosovare e Privatizimit me dt.05 nëntor 2013, ndërsa Autoriteti i Likuidimit e refuzoi kërkesën me dt.11 dhjetor 2013.

Gjykata konstaton se faktet e mëposhtme janë jokontestuese: Ankesa u regjistrua në Dhomën e Posaçme me dt.14 janar 2014, Ankuesi kishte punuar në NSH nga dt.01 prill 1987 deri me dt.16 maj 2007.

Gjykata i konstaton si kontestuese çështjet e mëposhtme: Pranueshmëria e ankesës varet nga përgjigja në çështjen e parashtrimit të ankesës brenda afatit të paraparë me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 04/L-034) dhe nenit 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Pranueshmëria

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme me dt.14 janar 2014, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI067-0058 dt.11 dhjetor 2013.

Po ashtu, gjykata gjen se është fakt i pa kontestuar se ankuesi ka punuar për NSH-në deri në marrje e njoftimit me dt. 16 maj 2007, që nënkupton se Gjykata merr parasysh kur e llogarit periudhën e punësimit e cila e përcakton shumën e parave që duhet të paguhet si dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës, faktin se ankuesit - punëtorit marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë deri me marrjen e njoftimit të dt. 16 maj 2007.

Ligji në fuqi

Ligji për Ndërmarrjet (77/88) hyri në fuqi më 01.01.1989 dhe është ligj në fuqi në Kosovë. Ligji për Ndërmarrjet i shfuqizon vetëm ato dispozita të Ligjit për Punën e Bashkuar që janë në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Ligji për Ndërmarrjet, sidoqoftë, nuk u jep ndonjë përgjigje çështjeve që trajtohen me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Për këtë arsye, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 parasheh se ligjet që janë miratuar nga Kuvendi i Jugosllavisë/Serbisë pas dt.22.03.1989 nuk janë ligje në fuqi në Kosovë.

Pasi që kërkesa është dorëzuar në AL brenda afatit, njoftimi për ndërprerje është i dt.16 maj 2007, rezulton se e drejta e ankuesit për dëmshpërblim është e afatshme, sikurse edhe me të njëjtën dëshmohet se ankuesit asnjëherë më parë nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim gjykata duke u bazuar në deklaratat e pakontestueshme të dyja palëve, edhe pse AL në mbrojtjen e paraqitur nuk e kontestoj asnjëherë si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e shumës të cilën e kërkoj ankuesi, gjykata gjeti se kërkesa e ankuesit është ligjore dhe asnjëherë nuk i ishte parashkruar, pasi që parashkrimi ishte ndërprerë me Njoftimin e dt. 16 maj 2007.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Futja e NSH në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur prirje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë.

Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dt. 16 maj 2007, dëshmon se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në deri me marrjen e këtij njoftimi, po ashtu kjo dëshmohet edhe vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja, pra e ai kishte ofruar shërbime për NSH-në deri në kohën e likuidimit të saj.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në shumën e Listave të pagave për vitin 2007, nga të cilat vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në nga dt.01 prill 1987 deri me dt.16 maj 2007, e që i bie se ka ofruar shërbime për 20.46 vite. Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 4 paga për ndërprerje të parakohshme të kontratës dhe shumën dhe lartësinë e pagave gjykata e morri në bazë të Listës së siguruar nga AL-ja në të cilat shifet se për muajt e fillimit të vitit 2007 shuma e pagës mujore ishte në lartësi prej 339.00 euro. Ashtu që duke llogaritur se ankuesi ka punuar më tepër se 20 vite të njëjtë sipas dispozitave të cekura më lartë i takojnë 4 paga 4 x 339 në shumë të përgjithshme prej 1,356.00 euro.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 135.60 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrije Shala